



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

**Nr.175, date 8.3.2017**

**PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE  
MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR (1)(2)**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ligjit 69/2012, "Për për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të inovacionit dhe ministrit të financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihet trajtimi me pagë për mësuesit/edukatorët në:

- a) arsimin parashkollor;
- b) arsimin fillor;
- c) arsimin e mesëm të ulët;
- ç) arsimin e mesëm të lartë;
- d) institucionet arsimore për përkudeshjen për kategori të veçanta të nxënësve.

2. Për punonjësit mësimorë dhe drejtues në, institucionet arsimore sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij vendimi, në bazat didaktike pranë shkollave teknike e profesionale, në konviktet e arsimit parauniversitar, si edhe në qendrat kulturore të fëmijeve, skema e strukturës së pagës është sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Struktura e pagës mujore përbëhet:

3.a Paga e grupit, (kolona 2 e Lidhjes nr.1) është paga për nivelin arsimor të kërkuar, vlera e së cilës përcaktohet sipas Lidhjes nr.2, "Paga për nivelin arsimor", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

“Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri para datës 1 Mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14.000 (katërbëdhjetëmijë) lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin arsimor përkatës. Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të Lidhjes nr. 2 të vendimit.”. (1)

3.b Shtesa për vjetërsi pune, (kolona 3 e Lidhjes nr. 1) aplikohet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, por jo më shumë se 25 vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi pagën e grupit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

3.c Shtesa për kualifikim, (kolona 4 e Lidhjes nr.1). Kjo shtesë jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit, në përqindje, si vijon:

- a) 5% të pagës së grupit, mbas përfitimit të shkallës “Mësues i kualifikuar”;
- b) 10% të pagës së grupit, mbas përfitimit të shkallës “Mësues specialist”;
- c) 20% të pagës së grupit, mbas përfitimit të shkallës “Mësues mjeshtër”.

3.d Shtesa e pozicionit, (kolona 5 e Lidhjes nr. 1) është e përcaktuar për çdo vend pune, sipas emërtesës përkatëse të pozicionit të punës.

4. Përveç pagës si më sipër, punonjësit mësimorë që punojnë larg vendbanimit përfitojnë një kompensim në masën si vijon:

4.a Kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është 2700 lekë në muaj.

4. b Kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është 6000 lekë në muaj.

Në të dyja rastet më sipër, kompensimi për largësi nga vendbanimi, nuk aplikohet për periudhën gjatë së cilës punonjësi mësimor kryen pushimet vjetore të pagueshme.

5. Punonjësit mësimorë efektivë, që për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën e lejuar mësimore, paguhen për çdo orë mësimore shtesë, në masën:

- Në shkollat e arsimit të mesëm të lartë 350 lekë/për orë;

- Në shkollat arsimit fillor dhe të mesëm të ulët 275 lekë/për orë.

6. Punonjësit e jashtëm, të specialiteteve të ndryshme, që japin mësim në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, në shkollat teknike e profesionale, si dhe në kurset e ndryshme (me përjashtim të kurseve, që ngrihen pranë shkollave të larta dhe institucioneve të tjera të kualifikimit të punonjësve mësimorë), për çdo orë mësimore paguhen në të njëjtën masë me punonjësit mësimorë efektivë, si më sipër.

7. Vendimi nr. 194, datë 22.4.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2017, të përballohen nga fondet e politikës për rritjen e pagave të përcaktuara në ligjin 130/2016, „Për buxhetin e vitit 2017.

8. Ngarkohet ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Struktura e pagës për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar**

	EMËRTIMI / POZICIONI	PAGA MUJORE			
		Paga individuale			Shtesa e Pozicionit
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
1	2	3	4	5	
1	Drejtor i shkollës së mesme me mbi 700 nxënës. Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë. Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë. Drejtor në shkollat me probleme mendore. Drejtor i konvikteve.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG.	58300
2	Drejtor i shkollës së mesme me 301 deri në 700 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	57750
3	Drejtor i shkollës së mesme me deri në 300 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	57200
4	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme me mbi 700 nxënës. Përgjegjës i bazës prodhuese. Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë. Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë. Zëvendësdrejtor në shkollat me probleme Mendore.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	52250
5	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme me 301 deri në 700 nxënës.		2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	51700
6	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme me deri në 300 nxënës.		2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	51150
7	Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	48950
8	Drejtor i shkollës 9-vjeçare me mbi 700 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	47850
9	Drejtor i shkollës 9-vjeçare me 301 deri në 700 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG;	47300

				20% e PG	
10	Drejtor i shkollës 9-vjeçare me deri në 300 nxënës.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	46750
11	Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV. Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive. Zëvendës drejtor i shkollës 9-vjeçare.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	45100
12	Drejtor i kopshtit me ushqim.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	43450
13	Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	42900
14	Drejtor i kopshtit pa ushqim.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	40150
15	Mësues në shkollat e mesme. Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë. Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë. Mësues në shkollat me probleme mendore. Psikolog shkolle. Mësues i praktikës profesionale. (2)	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	42350
16	Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	40150
17	Mësues në ciklin e lartë në shkollat 9-vjeçare	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	39050
18	Mësues në ciklin e ulët në shkollat 9-vjeçare. Edukator konvikti. Kujdestar konvikti.	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	36850
19	Edukator në kopësht fëmijësh	1	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	34650
20	Mësues në ciklin e ulët në shkollat 9-vjeçare. Edukator konvikti. Kujdestar konvikti	2	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	34650
21	Edukator në kopësht fëmijësh.	2	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	31350
22	Mësues në ciklin e ulët në shkollat 9-vjeçare. Instruktor I praktikës profesionale. (2)	3	2% e PG	5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG	31350

## Paga për nivelin arsimor

Grupi		Niveli I diplomës	Shuma lekë në muaj
Grupi 1,	Mësuesi i arsimit fillor, mësuesi i arsimit të mesëm të ulët dhe mësuesi i gjimnazit: Mësuesi i shkollave të arsimit profesional, që jep lëndë profesionale, ai i arsimit të orientuar dhe mësuesi, që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara	diplomë e ciklit të dytë të studimeve universitare apo të barazvlefshme me to sipas udhëzimit të Ministrit përgjegjës për arsimin.	14,000
Grupi 2	Mësuesi i arsimit parashkollor	diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare "Bachelor" apo të barazvlefshme me to sipas udhëzimit të Ministrit përgjegjës për arsimin.	11,000
Grupi 3	Personeli mësimdhënës, që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizkulturës, dhe që ka fituar tri shkallët e kualifikimit. Personeli instruktor i praktikës profesionale, i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme të profilizuar. (2)	Diplomë e shkollës së mesme pedagogjike, për të cilat jepet titulli "Mësues i shkollës fillore"; Diplomë e shkollës së mesme profesionale, për të cilat fitohet specialiteti për mësuesi; Diplomë mbi shkollën e mesme. Të tilla konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga Ministria e përgjegjëse për Arsimin, si dhe diplomat jouniversitare profesionale dyvjeçare. Diplomë e shkollës së mesme profesionale. (2)	10,000

Nr	VKM
1	351, datë 19.4.2017
2	265, datë 16.5.2018